



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-44539/2025

Klinë, datë 16/12/2025

Duke u bazuar ne nenin 13 nenin 62 pika 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 65 pika 12 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh autorizimet ligjore, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përkohshëm të Drejtorit të Drejtorisë së Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësive në Komunën e Klinës

1. NIKSON DAKA, i lindur me 03.10.1991 në fshatin Pjeterq i Poshtëm Komuna e Klinës, më numër personal të DI 1232447016, **EMËROHET**, përkohësisht Drejtor i Drejtorisë Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë në Komunën e Klinës.
2. I përmenduri si nga pika 1 e këtij vendimi fillon më ushtrimin e punëve dhe detyrave nga data e nxjerrjes së këtij vendimi, i cili punët dhe detyrat i kryen sipas Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjeve tjera pozitive, Udhëzimeve si dhe Rregulloreve tjera pozitive komunale si dhe udhëzimeve strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës, i cili i raporton rregullisht kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë e tij dhe i ofron atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.
3. Ky emërim është i përkohshëm dhe vlen deri në nxjerrjen e vendimit tjetër për emërimin e drejtorit të kësaj drejtorie.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- I përmenduri;
- Drejtoria e Kadastrit;
- Drejtoria e Financave;
- Zyra e Personelit;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari
Zenun Elezaq





Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 020-41485 /2025

Klinë, datë 16/12/2025

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare, me dt. 04.06.2008 nr.28, nenit 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh nevojat zyrtare, Kryetari i Komunës së Klinës, **mori**;

V E N D I M

1. **AUTORIZOHET**, Faruk Smajli i emëruar përkohësisht Drejtor i Drejtorisë së Financave, qe të nënshkruaj pagesat mujore dhe shkresat tjera të nevojshme procedurale për Drejtoritë komunale te cilat nuk kane te emëruar ende drejtor te drejtorive.
2. I përmenduri autorizohet përkohësisht në mungesë të drejtorëve të emëruar për nënshkrimin e pagesave.
3. Ky autorizim vlen deri ne emërimin e drejtorëve të drejtorive apo tërheqjen eventuale te tij nga ana e autorizim dhënësit.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Të njoftohen:

- I përmenduri;
- DFEZH;
- Ekzekutivi;
- Arkivi.

Kryetari
Zenun Elezaj





Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-61506 /2025

Klinë, datë 16 /12/2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar më dt.04.06.2008, dispozitat e nenit 5 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nr.03/L-072, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, dispozitat e nenit 8 të U.A te MAPL-së nr.01/2018, me rastin e inaugurimit të organeve të reja, Kryetari i Komunës së Klinës, **lëshon këtë;**

V E N D I M

1. KONFIRMOHET, se **Vjosa Gjetaj** e emëruar asistente administrative në zyrën e nënkryetares e komunës sipas vendimit, nr.01-112-34094/2023 të datës 28.09.2023, më rastin e inaugurimit të organeve të reja nga data 11.12.2025, sipas ligjit i ka përfunduar emërimi më automatizëm.
2. Zyra e Personelit në bashkepunim më Drejtorinë e Financave merr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale lidhur më përfundimin e emërimit të përmendurës.
3. Ky vendim ka karakter konfirmues procedural.

Te njoftohen:

- E përmendura;
- Drejtoria e Financave;
- Zyra e personelit;
- Ministria e Financave, si dhe;
- Arkivi.



Kryetari, *M*
Zenun Elezaj



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 118-41310 /2025

Klinë, datë 12/172025

Duke u bazuar në nenin 13, 58 dhe 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar më dt.04.06.2008, dispozitat e nenit 5 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nr.03/L-072, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, me rastin e inaugurimit të organeve të reja, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt.10.12.2021, nxjerr këtë;

V E N D I M

1. KONFIRMOHET, së më rastin e inaugurimit të organeve të reja përkatësisht Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, nga data 11.12.2025, sipas ligjit ju ka përfunduar mandati i funksionimit nënkryetares së komunës si dhe drejtoreshë të drejtorive komunale të përmendur, si në vijim:
 - 1.1. Marqe Selmanaj, nënkryetare e komunës;
 - 1.2. Binak Sylaj, Drejtor i Drejtorisë së Administratës;
 - 1.3. Qemajl Sejdia, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit;
 - 1.4. Lorenc Marleku, Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë;
 - 1.5. Driton Bardheci, Drejtor i Drejtorisë së Kulturës;
 - 1.6. Qendrim Millaku, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike;
 - 1.7. Enver Berisha, Drejtor i Drejtorisë së Financave;
 - 1.8. Agron Bacaj, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë;
 - 1.9. Faruk Smajli, Drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit;
 - 1.10. Nikson Daka, Drejtor i Drejtorisë së Kadastrit;
 - 1.11. Enver Berisha, Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit.
2. Të përmendurve konsiderohet se sipas ligjit ju ka përfunduar mandati i funksionimit nga data 11.12.2025 më rastin e inaugurimit të organeve të reja komunale.
3. Ky vendim ka karakter informues lidhur më mandatin e nënkryetares dhe drejtoreshë të drejtorive komunale.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- Drejtoria e Financave;
- Zyra e personelit;
- Ministria e Financave, si dhe;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-47760 /2025

Klinë, datë 11 / 12 /2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit, nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të dt.07.04.2010, e ne mbështetje të dispozitave të neneve 7 dhe 10 të Rregullores Komunale, nr.01-463-34997/2021 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më Pak së Një Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës nxjerr, **këtë:**

V E N D I M

Për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim
më pak së 1 vit të hapësirave publike

1. **FORMOHET**, komisioni komunal për shqyrtimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për shfrytëzimin e përkohshëm më pak së një (1) vit të hapësirave publike. Përbërja e komisionit është, siç vijon:
 - 1.1. Visar Bojaj, kryesues;
 - 1.2. Adnan Zeneli, anëtar;
 - 1.3. Xhezide Trapça- Gashi, anëtar;
2. Komisioni benë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim më pak së një vit, si dhe i rekomandon kryetarit të komunës për nënshkrimin e kontratës.
3. Komisioni punën e vet e kryen në përputhje më dispozitat e Rregullores për Përcaktimin e procedurave të dhënies më pak së një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, nr.01-463-34997/2021, si dhe dispozitat tjera ligjore dhe nënligjore pozitive të cilat rregullojnë këtë fushe.
4. Mandati i komisionit është dy (2) vite nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
5. Ky vendim është i plotfuqishëm nga data e nënshkrimit të tij nga Kryetari i Komunës.

Te njoftohen:

- Të përmendurit;
- Drejtoria e UMM;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj





Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-60528 / 2025

Klinë, datë 05 / 12 / 2025

Duke u bazuar në nenin 13, 58 dhe 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 91 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të datës 07.04.2010, ne mungesë të drejtorit të Drejtorisë së Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë, me qëllim që punët të kryhen pa pengesa, kryetari i komunës, lëshoj këtë:

V E N D I M

1. **AUTORIZOHET**, KRESHNIK RACAJ, i caktuar në vendin dhe detyrat e punës, U.D i udhëheqësit të sektorit për çështje pronësore në DKGJP, që në mungesë të drejtorit të Drejtorisë së Kadastrit nga data 05.12.2025 deri më kthimin e drejtorit të drejtorisë nga pushimi vjetor, t'i kryej të gjitha punët dhe detyrat nga kompetenca e drejtorit të Drejtorisë së KGJP.
2. I përmenduri punët dhe detyrat e kësaj drejtorie i kryen në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, si dhe udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit dhe për çdo veprim jashtë kompetencave të drejtorit të drejtorisë përgjigjet. Për punën e tij i raporton rregullisht kryetarit të komunës.
3. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë dhe do të vlejë deri në kthimin e drejtorit në punë.

Te njoftohen:

- I përmenduri;
- DKGJP;
- Zyra e Personelit, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari
Zenun Elezaj





Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-44279/2025

Klinë, datë 12/12/2025

Duke u bazuar ne nenin 13 nenin 62 pika 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 65 pika 12 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh autorizimet ligjore, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përkohshëm të Drejtorit të Drejtorisë së Financave në Komunën e Klinës

1. FARUK SMAJLI, i lindur me 09.01.1988 në fshatin Pjeterq i Eperm Komuna e Klinës, më numër personal të DI 1172884390, **EMËROHET**, përkohësisht Drejtor i Drejtorisë Financave, Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Klinës.
2. I përmenduri si nga pika 1 e këtij vendimi fillon më ushtrimin e punëve dhe detyrave nga data e nxjerrjes se këtij vendimi, i cili punët dhe detyrat i kryen sipas Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjeve tjera pozitive, Udhëzimeve si dhe Rregulloreve tjera pozitive komunale si dhe udhëzimeve strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës, i cili i raporton rregullisht kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë e tij dhe i ofron atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.
3. Ky emërim është i përkohshëm dhe vlen deri në nxjerrjen e vendimit tjetër për emërimin e drejtorit të kësaj drejtorie.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- I përmenduri;
- Drejtoria e Financave;
- Zyra e Personelit;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj